



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 53 Datë 23.6.08

PËR

Per miratimin e fondit prej 200 000 leke per shfaqjen e dy koncerteve nga Filarmonia e Korinthit, Greqi ne sheshin para Katedrales "Ringjallja e Krishtit".

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatorët për miratimin e fondit prej 200 000 "Për shfaqjen e dy koncerteve nga Filarmonia e Korinthit, Greqi në sheshin para Katedrales "Ringjallja e Krishtit", Në zbatim të ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjit nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligjit nr 9836 dt. 26.11.2007 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2008", Udhëzimit nr 4 dt. 17.01.2008 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008", Udhëzimit nr 258 dt.15.02.2008 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2008", si dhe V.K.B. nr. 12 dt. 18.03.2008 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit total prej 200 000 lekë për shfaqjen e dy koncerteve nga Filarmonia e Korinthit, Greqi në sheshin para Katedrales "Ringjallja e Krishtit" i detajuar si më poshtë

Pagese për dietat e trupës së aktoreve dhe teknikës:
25 persona x 2 000 leke x 4 ditë = 200 000 leke

TOTALI = 200 000 leke

2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore:

Pakesohet	00	04980	05	Art	6090000	- 200.000
Shtohet	00	08250	05	Art	6020000	+ 200.000

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatorët dhe Qendra Kulturore “Vangjush Mio”.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda Nase

Raimonda NASE

Dixhitalizuar nga Qendra
www.infocip.org